



USAID | **ALBANIA**
FROM THE AMERICAN PEOPLE

PRESS RELEASE

Artizanati për Nxitjen e Zhvillimit Ekonomik të Shkodrës

SHKODËR, 18 DHJETOR, 2009 U hap sot në Shkodër panairi “Artizania Shkodrane 2009”. Veprimtaria tre-ditore që u organizua në ambientet e Hotel Rozafës prezantoi produkte të ndryshme tradicionale të zonës, si pëlhura të llojeve të ndryshme, punime argjendi dhe bakri, qilima e sixhade tradicionale me lesh vendi, kostume kombëtare, punime druri, qëndisje e punime të tjera artistike.

Panairi u organizua nga Shoqata “Gruaja Intelektuale Shkodrane” (IWS), e mbështetur me një grant nga Program i Qeverisjes Vendore të USAID dhe Bashkia e Shkodrës. Ai kontribuoi në promovimin e produkteve artizanale të prodhuara nga gratë shkodrane, si edhe tërhoqi mjaft vizitorë e blerës potencialë. Më shumë se 25 gra artizane nga rajoni i Shkodrës dhe të ftuara nga Kosova e Mali i Zi patën rastin të ekspozonin dhe nxirrnin të ardhura nga shitja e produkteve të tyre në panair.

Prodhimet artizane janë një shprehje unike dhe përfaqësojnë kulturën, traditën dhe pasurinë e një kombi. Ato janë me rëndësi të madhe për zhvillimin ekonomik, pasi ofrojnë mundësi punësimi, edhe pse me kapital të vogël investimi. “Prodhimet artizanale të zonës së Shkodrës janë të mirënjohura në mbarë Shqipërinë, e sidomos për blerësit e huaj që janë të mrekulluar prej tyre. Ato janë një nga shumë atraksionet që Shkodra ofron dhe ne duhet të vazhdojmë përpjekjet tona për të ndjekur vijuar traditën ” u shpreh koordinatorja e Panairit “Artizania Shkodrane 2009”, Znj. Zenepe Dibra, Drejtore Ekzekutive e Shoqatës “Gruaja Intelektuale Shkodrane” (IWS).

Panairi është një nga aktivitetet e shumta që Programi i USAID për Qeverisjen Vendore ka organizuar në mbështetje të Bashkisë së Shkodrës.

Programi i Qeverisjes Vendore në Shqipëri (LGPA) i USAID punon me bashki partnere në të gjithë Shqipërinë me qëllim që të mbështesë zhvillimin e ekonomisë vendore, të përmirësojë qeverisjen dhe të forcojë pjesëmarrjen e shoqërisë civile dhe sektorit privat në zhvillimin vendor. Bashkitë partnere të LGPA janë Fieri, Fushë Kruja, Elbasani, Gramshi, Korça, Kukësi, Lezha, Librazhdi, Pogradeci, dhe Shkodër.

###